



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2022:248676

Datë: 22.02.2024

Numri i dokumentit: 05362551

C.nr.548/22

GJYKATA THEMELORE PEJË-DEGA NË KLINË-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Fllanza Hashani, në çështjen juridike kontestimore të paditësit P. M. N. nga fshati K... e M... , Komuna Klinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson P. P. avokat nga K... , kundër të paditurës D. Gj. N. nga K... me vendbanim në rrugën Sheshi "...", për vërtetim pronësie në bazë të pohimit, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor publik me datë 05.02.2024, në të cilën ish-in të pranishëm i autorizuari i paditësit dhe e paditura, me datë 20.02.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M
Në bazë të pohimit

I.APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkespadia e paditësit P. M. N. nga fshati K... e M... , Komuna Klinë.

II.VËRTETOHET se paditësi P. M. N. i takon e drejta e pronësisë në paluajtshmëritë si në vijim:

- Banesës (njësi kadastrale e ndërtesës) me nr.identifikues kadastral ... ZK, K... në sipërfaqe prej 86m², me shfrytëzim aktual banesë e cila shtrihet në kuadër të parcelës kadastrale numër ... ZK K... në sheshin "...", kodi i hyrjes ..., kati ... me numër ...;
- Parcelës kadastrale me numër identifikues kadastral ... ZK K..., vendi i quajtur ... , në sipërfaqe 289 m², me kulturë ndërtimore dhe oborr e cila nga pjesa veriore kufizohet me pronën publike rrugët, dhe me njësinë kadastrale nr. ... , në anën lindore kufizohet me parcelën nr. ... dhe , ndërkaq në anën jugore dhe përendimore kufizohet me parcelën kadastrale ... me kulturë rrugë;
- Parcelës kadastrale me numër identifikues kadastral ... ZK K... , në vendin e quajtur ... , në sipërfaqe të përgjithshme prej 426m², e cila në pjesën veriore kufizohet me parcelën nr. ... me kulturë rrugë, në pjesën lindore kufizohet me parcelën ... , në pjesën jugore kufizohet me parcelën ... , si dhe në pjesën përendimore kufizohet me parcelën ...;
- Parcelës kadastrale nr. identifikues kadastral ... ZK K... , në sipërfaqe të përgjithshme prej 1733 m², me kulturë livadh, klasa e dytë, në vendin e quajtur Lagja e ulët, e cila në pjesën veriore kufizohet me parcelën nr. , në pjesën lindore kufizohet me parcelën

... , në pjesën jugore kufizohet me parcelën ... , si dhe në pjesën përfundimtare kufizohet me parcelën ... ;

- Parcelës kadastrale me nr. identifikues kadastral nr. ... , ZK K... , në sipërfaqe prej 320 m², me kulturë arë e klasit të tretë, vendi i quajtur ..., e cila në pjesën veriore kufizohet me parcelën ... dhe ... , në pjesën lindore kufizohet me parcelën ... , në pjesën jugore kufizohet me parcelën ...-psh rrugët, si dhe në pjesën përfundimtare me parcelat ... dhe ... dhe

- Parcelës kadastrale me numër identifikues kadastral ... ZK K... , në sipërfaqe të përgjithshme prej 8287m², me kulturë livadh, klasi i dytë, në vendin e quajtur ... , e cila në pjesën veriore kufizohet me parcelën ...-PSH Rrugët, në pjesën lindore kufizohet me parcelat nr. ... dhe... , në pjesën jugore kufizohet me parcelën nr. ... ZK J..., dhe në pjesën përfundimtare kufizohet me parcelën nr. ...

III.DETYROHET e paditura D. Gj. N. që paditësit ti njeh të drejtën e pronësisë në paluajtshmëritë si në pikën II të dispozitivit dhe të lejojë që paluajtshmëritë e theksuara të regjistrohen në emër të paditësit në regjistrin e të drejtave për pronë të paluajtshme të Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë në ZK Klinë, në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktgjykimi nën kërcënimin e përmbartimit me dhunë.

IV. Secila palë bartë shpenzimet e veta procedurale.

Arsyetim

Paditësi pranë kësaj gjykate më dt.16.11.2022 , përmes të autorizuarit të tij ka ushtruar padi kundër të paditurës, për vërtetim pronësie nga baza e shitëblerjes me pohim.

Paditësi përmes të autorizuarit të tij në padi dhe gjatë seancave gjyqësore ka theksuar se paditësi me të paditurën në bazë të kontratës së shitëblerjes e pa vërtetuar tek organi kompetent ka blerë paluajtshmërinë lëndore me çmimin e shitëblerjes prej 45,000.00 Euro, të cilin e ka paguar me para në dorë, shitëblerja ka të bëjë me pes parcela dhe një banesë, dhe ka hyrë në posedim të lirë që nga ajo kohë e deri më sot i papenguar nga askush. Pas pranimit të ekspertizës dhe plotësimit të saj nga eksperti gjeodet ka bërë precizimin e padisë në seancën e dt.05.02.2024 bazuar në ekspertizën dhe plotësimin e saj. Më tej ka theksuar se nga provat e administruara është vërtetuar se paditësi ka fituar pronësinë në paluajtshmëritë lëndore dhe ka propozuar që kërkespudinë ta aprovoj si të bazuar dhe të nxirret aktgjykim në bazë të pohimit.

E paditura në përgjegjje në padi dhe gjatë seancave gjyqësore ka deklaruar se e pohon kërkespudinë e paditësit dhe kërkesën e saj si dhe faktet dhe gjendjen faktike, duke shtuar se paluajtshmëritë ia ka shitur dhe ka pranuar çmimin e shitëblerjes dhe i njëjti ka hyrë në posedim dhe i shfrytëzon që nga ajo kohë i papenguar nga askush, dhe lidhur me këtë nuk ka asgjë kontestuese. Më tej ka shtuar se pronën e saj ia ka shitur paditësit në vitin 2021 në bazë të kontratës interne dhe paditësi ka paguar çmimin e shitjes, shitëblerja ka të bëjë me pes parcela dhe një

banesë, duke shtuar se parcelat dhe banesa janë shitur me dëshirën time dhe pagesa është kryer në tërësi andaj paditësi i shfrytëzon këto paluajtshmëri

Gjykata nga shqyrtimi i gjithmbarshëm i çështjes, edhe përkundër pohimit të kërkesëpadisë nga e paditura, gjykata ka shtyrë marrjen e aktgjykimit në bazë të pohimit, kurse ex officio me qëllim të verifikimit dhe marrjes së njoftimeve të duhura në kuptim të nenit 3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka caktuar seancën e vendshiqimit dhe nxjerrjen e provës përmes ekspertizës së gjeodezisë. Pas pranimit të së njëjtës, është bërë precizimi i kërkesëpadisë.

Nga ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë, B. V. dt. 23.11.2023 e plotësuar më dt. 22.12.2023, gjykata ka vërtetuar se njësia banesore ... në sipërfaqe prej 86m², në vendin e quajtur F... , ZK Klinë e cila shtrihet në kuadër të parcelës kadastrale numër ... ZK K... në sheshin “...” kodi i hyrjes ...,kati...me numër ... , dhe evidentohet në emër të të paditurës D. Gj. N. , parcela kadastrale nr. ... ZK K... , vendi i quajtur ... , në sipërfaqe 289 m², me kulturë ndërtimore dhe oborr evidentohet në emër të D. Gj. N. , e cila nga pjesa veriore kufizohet me pronën publike rrugët, dhe me njësinë kadastrale nr. ... , në anën lindore kufizohet me parcelën nf. ... dhe ... , ndërkaq në anën jugore dhe përendimore kufizohet me parcelën kadastrale ... me kulturë rrugë. Parcela kadastrale me numër ... ZK K... , në vendin e quajtur ... , në sipërfaqe të përgjithshme prej 426m²,evidentohet në emër të D. Gj. N. , e cila në pjesën veriore kufizohet me parcelën nr. ... me kulturë rrugë, në pjesën lindore kufizohet me parcelën ... , në pjesën jugore kufizohet me parcelën ... , si dhe në pjesën përendimore kufizohet me parcelën Parcela kadastrale nr. ... ZK K... , në sipërfaqe të përgjithshme prej 1733 m², me kulturë livadh, klasa e dytë, në vendin e quajtur ... , evidentohet në emër të D. Gj. N. , e cila në pjesën veriore kufizohet me parcelën nr. ... , në pjesën lindore kufizohet me parcelën ... , në pjesën jugore kufizohet me parcelën ... , si dhe në pjesën përendimore kufizohet me parcelën Parcela kadastrale nr. ... , ZK K... , në sipërfaqe prej 320 m², me kulturë arë e klasit të tretë, vendi i quajtur... , evidentohet në emër të D. Gj. N. , e cila në pjesën veriore kufizohet me parcelën ... dhe ... , në pjesën lindore kufizohet me parcelën ... , në pjesën jugore kufizohet me parcelën ...-psh rrugët, si dhe në pjesën përendimore me parcelat ... dhe Parcela kadastrale nr. ... ZK K... , në sipërfaqe të përgjithshme prej 8287m², me kulturë livadh, klasi i dytë, në vendin e quajtur ... , evidentohet në emër të D. Gj. N. , e cila në pjesën veriore kufizohet me parcelën ...-PSH Rrugët, në pjesën lindore kufizohet me parcelat nr. ... dhe ... , në pjesën jugore kufizohet me parcelën nr. ... ZK J... , dhe në pjesën përendimore kufizohet me parcelën nr.Gjithashtu edhe nga dëgjimi i ekspertit në seancën e dt.05.02.2024, i njëjti ka sqaruar se fjala është për parcela të plota dhe ka konfirmuar se sipërfaqja e parcelës ... është 426m².

Gjykata pas analizimit të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, thënieve në padi dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga të paditurit, ka gjetur se janë në harmoni me njëra tjetrën dhe me pohimin e palës së paditur, nga të cilat vërtetohen faktet relevante se palët mund të disponojnë me kërkesat e tyre, pasi që e paditura është pronare e ngastrave lëndore dhe e banesës, të cilat bazuar në certifikatat e pronës, evidentohen në emër të saj e që vërtetohet edhe nga ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë.

Pasi që gjykata është bindur së bëhet fjalë për kërkesa të disponueshme të palëve në kuptim të nenit 148.1 të LPK-së, pa shqyrtim të mëtejshëm vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Meqenëse, në rastin konkret kemi të bëjmë me pohimin e kërkesëpadisë dhe është nxjerr aktgjykim në bazë të pohimit, atëherë gjykata arsyetoi vetëm arsyet të cilat e justifikojnë dhënien e këtij aktgjykimi konform nenit 160 paragrafi 6 të LPK-së.

Në lidhje me vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata ka vendosur si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi konform nenit 450 të LPK-së, meqenëse asnjëra palë nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Nga arsyet e dhëna më lartë u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, e në kuptim të nenit 148 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PEJË-DEGA NË KLINË,
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr. 548/22, datë 20.02.2024

Gjyqtarja,
Fllanza Hashani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve pas ditës së marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate. Bazuar në nenin 181.2 të LPK-së, ky aktgjykim mund të goditet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, apo nga shkakut se deklarata e pohimit është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin eventuale të dhunës apo mashtrimit..